

Leksioni 5

KALLËZUESI

Kallëzuesi është gjymtyra kryesore e fjalisë dykryegjymtyrëshe, e shprehur me folje, që hyn në marrëdhënie e lidhje kallëzuesore me kryefjalën.

Telefoni ra përsëri.

Suzana e kishte dëgjuar me kryet ulur.

Ai buzëqeshi hutueshëm.

Kallëzuesi është gjithnjë në lidhje me kryefjalën dhe anasjelltas.

Ato nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin.

Dallojmë disa lloje kallëzuesi :

1. Kallëzuesi i shprehur me folje

Kallëzuesi i shprehur me folje ose kallëzuesi foljor është dy llojesh :

a. i thjeshtë

b. i përbërë.

A. Kallëzuesi i thjeshtë foljor.

Kallëzuesi i thjeshtë foljor shprehet me një formë foljore të çdo vete, kohe e diateze, në një nga mënyrat e foljes.

Forma më e zakonshme e shprehjes së kallëzuesit të thjeshtë është veta e trete njëjës e shumës. Për shembull :

Ushitari ngriti supet dhe mënjanoi kryet si fajtor.

Unë zgjata dorën për t'u ndarë me të.

Tjetri shtangu më keq.

Sytë i dhembnin nga lodhja.

Kallëzuesi i thjeshtë mund të shprehet :

- me një nga mënyrat e foljes,
- me anë të foljes ndihmëse *kam + paskajore* ose *jam + përcjellore*,
- me forma të pashtjelluara të foljes,
- me forma të ndërlikuara.

➤ **Kallëzuesi i shprehur me një nga mënyrat e foljes.**

Kur themi se kallëzuesi shprehet me një nga mënyrat e foljes, do të thotë se shprehet me folje të mënyrës dëftore, lidhore, habitore, kushtore, dëshirore apo urdhërore.

Kallëzuesi i shprehur me *folje në dëftore* në çdo kohë të saj është më i zakonshmi, përdoret në të gjitha tipat e fjalive, i shoqëruar shpesh me pjesëza të ndryshme.

*Në këmbët e kodrave **shtrihen** fshatra të vogla.*

*Të dy **shqiptuan** pak a shumë të njëjtat fjalë.*

Ndër kallëzuesit e thjeshtë foljorë që shoqërohen me pjesëza, janë edhe ata që marrin përpara pjesëzat *sa, mend, desh*, që shërbejnë për të shënuar një veprim që arrin deri në cakun e realizimit të tij, po nuk realizohet.

*Pemët **sa nuk thyheshin** nga pesha e kokrrave.*

***Mend qau** kur e pa në atë ditë.*

*Nga lodhja **desh u rrëzua** për tokë.*

Kallëzuesi i shprehur me folje në mënyrën *habitore* përdoret kryesisht në fund të fjalisë dëftore e pyetëse-thirrmore :

*Po ja që zemra e një vajze nuk **u fituaka** me zor.*

*O burra të ikim, se na **qenkan gdhirë** trima sot!*

*Ç'më **qënkej shëmtuar** aq shumë me ato rroba ?!*

Me format e *lidhore* kallëzuesi është tipik për pjesët e nënrenditura të fjalive të përbëra, por përdoret edhe në fjali të mëvetësishme, zakonisht pyetëse, nxitëse e dëshirore.

*Të nesërmen u ngrit shpejt **që të mos vonohej**.*

*Kur të **ketë martuar** ata, do të vdesë me mendje të mbledhur.*

*T'i kishte **thënë** një fjalë të paktën!*

*Të **kenë ardhur** vallë!*

*Të mos e **kishte parë**?*

*Të **kishe ngrënë** edhe ti pak, se ke rrugë për të bërë.*

Kallëzuesi i shprehur me format e **kushtores** përdoret në pjesët kryesore të fjalive të përbëra, me fjali të nënrenditura kushtore dhe në fjali të mëvetësishme ose të bashkërenditura.

*Sikur të mos kishin ndërhyrë të tjerët, **do të kishte përfunduar** keq puna.*

*Ndryshe **do të derdhej gjak** më kot dhe përfundimi **do të ishte** një robëri më e keqe se e para.*

*Edhe në qoftë se **do të kishte ndodhur** në një gëzim të tillë, ai **do ta kishte përbuzur**.*

Me format e **dëshirores** kallëzuesi është karakteristik për fjalitë dëshirore dhe për pjesët e nënrenditura të fjalive të përbëra kushtore e lejore me lidhëzën *në* :

*Ju **këndoftë** zemra, se më kënaqët.*

Mallkimi më i rëndë rëntë mbi të ligjtë e përçarësit.

*Në **vonoftë** sonte, mos e pritni!*

*Edhe në **pastë ardhur** i lodhur, ai do të na presë.*

Me format e **urdhërores** përdoret në fjali të mëvetësishme nxitëse dhe në fjali të tilla kryesore pranë një kryefjale të shprehur me përemrat vetorë *ti, ju*:

***Ik** dhe ti bashkë me ta.*

*Ju **mos shkoni** nga ajo rrugë, se nuk ia dilni dot.*

➤ **Kallëzuesi i formuar me kam + paskajore dhe jam + përcjellore.**

Me vlerën e një kallëzuesi të thjeshtë foljor në mënyrën dëftore dalin dhe format periferike të foljeve që ndërtohen me :

- foljen **kam** në të tashmen ose në të pakryerën e dëftores + formën e pashtjelluar të paskajores së foljes. Ato kanë vlerën e së ardhmes (*kam për të bërë = do të bëj*) ose të së ardhmes së të shkuarës (*kisha për të bërë = do të bëja*) :

*Do të çlodhen dhe rrobat **kanë për t'u tharë**.*

*Ai **kishte për të ardhur**, po nuk erdhi.*

- me foljen **jam** në të tashmen ose në të pakryerën e dëftores + një formë foljore të pashtjelluar të përcjellores së foljes. Ato kanë vlerën e së tashmes (*jam duke bërë = po bëj*) ose të së pakryerës të aktualizuar që shënon një veprim të zgjatur (*isha duke bërë = po bëja*).

Ne jemi duke e ngritur edhe më lart qytetërimin.

Dielli ishte duke perënduar.

➤ **Kallëzuesi i shprehur me forma të pashtjelluara të foljes.**

Në funksion të kallëzuesit përdoren edhe format e pashtjelluara.

- Forma e pashtjelluar e tipit *pa bërë* përdoret si kallëzues në pjesët e nënrenditura të fjalive të përbëra kohore, kushtore, lejore ose mënyrore, p.sh.:

*Babai është nisur **pa dalë dielli**.*

*A s'ia arrita qëllimit edhe **pa më ndihmuar** ti?*

***Pa na dhënë** shenjën Bujari, ne nuk mund të nisemi.*

- Forma e pashtjelluar *përcjellore* përdoret si kallëzues në pjesët e nënrenditura të fjalive mënyrore, shkakore, kushtore,

***Duke mos ndenj**ur në krye **ju**, s'ka si të ecë puna mirë.*

- Forma e pashtjelluar *paskajore* përdoret si kallëzues në pjesët e nënrenditura të fjalive qëllimore :

*Një përgjigje e tillë mjaftonte **për t'u provuar mendja** e saj.*

*Nata ra jo **për të mbledhur** kockat robi, por **për të dalë** i ligu nga ferra.*

*Një përgjigje e tillë mjaftonte **për t'u provuar mendja** e saj.*

- Forma e pashtjelluar e tipit *me të bërë* përdoret si kallëzues në pjesët e nënrenditura kohore :

***Me të zbardhur drita**, u çuan që të dy nga shtrati.*

*Jo i them, se **me t'u martuar** çdo gjë do të ndryshojë.*

- Forma e pashtjelluar e tipit *një të bërë* përdoret si kallëzues kryesisht në fjalitë e bashkërenditura. Është karakteristik për stilin tregimtar.

E mor Leks, një të ikur unë nga shtëpia dhe një t'u shthurur gardhi.

➤ **Kallëzuesi i shprehur me forma të ndërlikuara.**

Kallëzuesi i thjeshtë mund të paraqitet jo vetëm me një fjalë, po edhe me dy a më shumë fjalë, zakonisht folje që përsëriten ose me dy forma të ndryshme të së njëjtës folje. Të dyja foljet së bashku tregojnë një mënyrë veprimi, si : zgjatje, përforsim, theksim etj., prandaj edhe trajtohet si një rast i kallëzuesit të thjeshtë foljor.

Kallëzues të tillë kanë vlerë stilistike. Ata mund të ndërtohen në mënyra të ndryshme. Mund të shprehen me përsëritjen e së njëjtës formë foljore në mënyrën dëftore ose urdhërore, të cilat mund të lidhen me lidhëzat bashkërenditëse *e, dhe* ose edhe pa lidhëza. Kur përsëritet forma e së pakryerës, e së tashmes, e së ardhmes dhe format e urdhërores ai tregon një veprim me zgjatje të pakufizuar.

Mendimet e gjeneralit vërtiteshin e vërtiteshin në të njëjtën pikë.

Bërtet e bërtet e kurrkush s'i përgjigjet.

Do të flasin, do të flasin, pastaj do të lodhen.

Prit e prit ky, dikur e humbi durimin e u ngrit e iku

Kur përsëriten format e së kryerës së thjeshtë, të së kryerës dhe të më se të kryerës apo edhe të kohëve të tjera, tregon një veprim të përforsuar, intensiv. Veçori për këtë kallëzues është forma pohore e foljeve dhe lidhja e tyre me lidhëzën *e*.

Dhe vasha qau e qau sa u tret.

Ata i kishin folur e i kishin folur sa s'i kishin lënë gjë pa thënë.

Kur forma të njëjta të mënyrës dëftore përsëriten e lidhen me anë të lidhëzës *sa*, kallëzuesi tregon një veprim me zgjatje të pakufizuar. Fjalja që ka këtë kallëzues ndiqet nga një fjali e bashkërenditur me lidhëzat *e, dhe*, duke kumtuar një veprim që ndërpret të parin.

Urrejtja zien sa zien brenda, pastaj shpërthen.

Punonte sa punonte dhe bënte pushim.

Rrinte sa rrinte dhe brof ia bënte e kriste e ikte.

Kur format e përsëritura lidhen me lidhëzën *që*, jepet një veprim i përforcuar ose një veprim që motivon një veprim tjetër:

Bariu plak s'e la që s'e la pa e gostitur.

Nuk desh që nuk desh ta linte vetëm.

Nguli këmbë dhe i doli që i doli e tija.

Erdhën që erdhën, të rrinë edhe pak.

Kallëzuesi i thjeshtë foljor mund të shprehet edhe me dy forma të ndryshme të së njëjtës folje ose me dy fjalë me rrënjë të njëjtë.

Ai që shprehet me dy forma të ndryshme të së njëjtës folje, formohet nga paskajorja e një foljeje e ndjekur nga një formë kohore e saj në mënyrën dëftore ose urdhërore dhe shpreh një veprim të theksuar, të sigurt. Paskajorja qëndron para formës kohore, por edhe pas saj.

Këmbët iu morën, po për të rënë s'ra.

Ti e kupton se për të ikur s'ikën dot.

Degën e kapi për të kapur, por s'e mbajti dot.

Kallëzuesi që shprehet me dy fjalë me rrënjë të njëjtë, formohet nga një emër prejfoljor, asnjans dhe nga forma e vetës së tretë e së tashmes a e së pakryerës së dëftores së foljes prej së cilës vjen emri foljor, të bashkuara me lidhëzën *që* dhe shpreh një veprim të përforcuar që ngjall habi. Shpesh në vend të foljes del folja *bëj* në vetën e tretë me kuptim të përgjithshëm :

Të ecur që ecën ky fëmijë.

Të folur që fliste, veç ta dëgjoje.

Të kënduar që bën plaku.

Kallëzuesi i thjeshtë mund të shprehet edhe me *shprehje frazeologjike* me vlerë foljore, si: *vë re, bëj ballë, vë dorë, hedh shtat, marr vesh, ngul këmbë, (i) jap udhë, (e) vë në udhë* etj.

Nuk po marr vesh ç'bëhet.

E kush mund të verë dorë mbi të!

Fjala kishte marrë dhenë.

Ju ngulni këmbë në një çështje që konsiderohet e mbyllur.

Ata u bëjnë ballë vështirësive me guxim.

B. Kallëzuesi i përbërë foljor

Kallëzuesi i përbërë foljor formohet nga dy fjalë emërtuese nga të cilat e para tregon mënyrë veprimi (fillim, vazhdim, mbarim, përforcim, rritje progres) ose modalitet (domosdoshmëri, supozim, mundësi etj.), kurse e dyta shpreh një veprim.

Kjo gjymtyrë e përbërë prej dy pjesësh, është formuar si një tërësi e vetme nga ana e përmbajtjes dhe nga ana gramatikore. Të dyja pjesët që formojnë kallëzuesin e përbërë, shërbejnë si qendër ndërtimore e fjalisë.

Klasifikimi i kallëzuesit të përbërë do të bëhet duke u nisur nga mënyra morfologjike e pjesës së dytë. Kështu, dallojmë :

- kallëzues të përbërë që e ka pjesën e dytë një folje në lidhore;
- kallëzues të përbërë që e ka pjesën e dytë një formë të pashtjelluar foljore;
- kallëzues të përbërë që e ka pjesën e dytë një emër të foljor asnjës;
- kallëzues të përbërë me dy folje në mënyrën dëftore.

➤ **Kallëzuesi i përbërë me pjesë të dytë një folje në mënyrën lidhore.**

Ky kallëzues ka si pjesë të parë një folje gjysmëndihmëse që mund të shprehë:

- **Fillimin e veprimit**, të tilla si : *filloj, zë, nis, marr*. Ky kallëzues shënon fillimin e veprimit. Këtë kuptim e jep folja gjysmëndihmëse, ndërsa pjesa e dytë, folja në lidhore, shpreh veprimin përkatës në fillimin e vet. Veprimi që shënohet, është një veprim që zgjatet, që ka filluar në një çast të caktuar të së shkuarës dhe vazhdon të realizohet edhe në çastin e ligjërit:

Ti ke ndryshuar që kur zure të shoqërohesh me atë,

ose që fillimi e vazhdimi i tij i përkasin një periudhe kohore para çastit të ligjërit:

Djali filloi të qeshte me zë.

Folja gjysmëndihmëse mund të dalë në të gjitha format kohore të mënyrës dëftore, rrallë edhe në lidhore e urdhërore; folja në lidhore del në format kohore të së tashmes ose të së pakryerës.

- **Vazhdimin e veprimit**, të tilla si : *vazhdoj, vijoj*. Këto folje pasohen nga një folje në të tashmen a në të pakryerën e lidhores. Ai shënon një veprim të vazhduar.

Shefi i madh vazhdonte të heshte i pikëlluar.

Vesa vazhdonte të pikonte nga pishat.

Secili vijonte të këndonte në të tijën.

- **Veprim të sforcuar**. Kallëzuesi formohet nga folja gjysmëndihmëse *bëj* zakonisht në format kohore të së tashmes e të së kryerës së thjeshtë, duke shënuar një veprim në fillimet e veta, një veprim të sforcuar, që mbetet në orvatje, pa u realizuar dhe nga folja në mënyrën lidhore që shpreh përmbajtjen leksikore të tij dhe lidhjen me kryefjalën. Ky lloj kallëzuesi përdoret zakonisht në një fjali të përbërë me raporte kundërshtore, si :

Plaku bëri të ngrihej, po s' u ngrit dot.

Bëj të fle, gjumi s' më zë.

Bën të dalë e nuk del dot.

- **Mundësi**. Ky tip kallëzuesi formohet nga folja gjysmëndihmëse *mund* në formën kohore të së tashmes, veta III njëjës dhe nga folja në lidhore në të gjitha format kohore të saj. Folja *mund* i jep kallëzuesit kuptimin modal të mundësisë, ndërsa folja në lidhore shpreh përmbajtjen leksikore të tij dhe lidhjen me kryefjalën. Po kallëzuesi i përbërë me këtë folje mund të tregojë edhe veprim të dyshimtë:

Ato shenja mund të merreshin fare lehtë si provë e përgjithshme.

Po përpiqesha të zbuloja se kush mund të kishte qenë.

Si mund ta bëjë ai një gjë të tillë!

Çfarë halli mund të qash me arë.

Në formën e tij mohore ky kallëzues mund të marrë pjesëza mohuese, si para foljes *mund* për të mohuar mundësinë e realizimit të veprimit, ashtu edhe para foljes në lidhore për të mohuar veprimin.

Njeriu nuk mund të rrojë i vetmuar.

Biblioteka nuk mund të mos ishte e hapur.

- **Domosdoshmëri.** E tillë është folja gjysmëndihmëse *duhet* që i jep kallëzuesit kuptimin modal të domosdoshmërisë, ndërsa folja në lidhore shpreh përmbajtjen leksikore dhe lidhjen me kryefjalën.

Tani duhet të përfytyrojmë çdo gjë ngadalë, me kujdes.

Këtë urdhër duhej të zbatonte.

Kjo duhej të kishte ndodhur dy muaj më parë.

Nuk duhej të kishin qenë larg minierat e argjendit.

Kallëzuesi i përbërë që shpreh domosdoshmëri mund të marrë pjesëza mohuese si para foljes *duhet*, për të mohuar domosdoshmërinë e realizimit të veprimit, ashtu edhe para foljes në lidhore, për të mohuar veprimin.

Kali i drunjtë s'mund të ishte një tunel.

Ti nuk duhet të flasësh.

Ju duhej të mos ju zinte gjumi për këtë gjendje.

Kur folja *duhet* dhe folja në lidhore kanë kryefjalë të ndryshme, nuk formojnë së bashku një kallëzues të përbërë, po secila një kallëzues të thjeshtë. Në këto raste, si kryefjalë e foljes *duhet* shërben pjesa e nënrenditur me foljen në lidhore:

Vitës i duhej të shpejtonte hapin.

- **Kallëzuesi i përbërë me pjesë të dytë një folje me formë të pashtjelluar dhe me pjesë të parë një folje gjysmëndihmëse.**

Ky kallëzues paraqitet me këto struktura:

- **Duhet + pjesore.** Folja gjysëmndihmëse shprehet në të tashmen ose në të pakryerën (zakonisht veta II a III njëjës e shumës) e dëftores e më rrallë të habitores. Ky kallëzues shpreh një veprim, realizimi i të cilit është i domosdoshëm.

Ti duhesh kritikuar.

Duhet bërë diçka për këta njerëz.

Kjo çështje duhet mbrojtur deri në fund.

Aty ishin dokumentet që duheshin zhdukur.

Nuk e kuptoj pse u dashka mbyllur dyqani.

- **Do + pjesore.** Nga ana gramatikore ky kallëzues ka vlerë të njëjtë me kallëzuesin më lart. Folja gjysëmndihmëse përdoret në formën e vetës së tretë njëjës e shumës të së tashmes së dëftores. Folja gjysëmndihmëse dua i jep kallëzuesit kuptimin modal të domosdoshmërisë, si diçka që e meriton ose e kërkon vetë sendi i shprehur nga kryefjala.

Nderi do shpërblyer me nder.

Do pyetur edhe ai për këtë.

Këto duan vënë përpara me hu.

- **Vij + përcjellore.** Nëpërmjet këtij kallëzuesi shprehen veprime, gjendje a situatë në rritjen e tyre progresive. Folja gjysëmndihmëse vij përdoret kryesisht në vetën e tretë njëjës ose shumës në kohë të ndryshme të dëftores, shpreh rritjen progresive dhe lidhjen me kryefjalën, kurse folja në përcjellore shpreh përmbajtjen leksikore të kallëzuesit.

Tronditja e saj vjen duke u rritur.

Temperatura vinte duke rënë.

Uturima erdhi duke u duke u shtuar.

Kushtet kishin ardhur duke u përmirësuar.

- **Kall. i përbërë me pjesë të dyta një emër foljor asnjës dhe me një folje gjysëmndihmëse përpara.**

Kallëzuesi i përbërë i formuar nga folja *mbaroj* apo *pushoj* në format kohore të dëftores, më rrallë në format kohore të lidhores, të habitores a të dëshirores, dhe nga një emër asnjans në rrjedhore shpreh mbarimin e veprimit.

Tokat po mbaronin së ndari.

Bari u tha e qyqja pushoi së kënduari.

A do të mbarojë së foluri ndonjëherë?

Vajzat kishin pushuar së korruri.

Në formën kohore tregon një veprim që zgjat :

Aeroplanët s'pushonin së hedhuri bomba.

Ajo sot s'pushon së foluri.

➤ **Kallëzuesi i përbërë me dy folje në dëftore.**

Foljet *filloj*, *zë*, *nis* me kuptimin e fillimit e në format kohore të dëftores mund të bashkohen me anë të lidhëzës *e*. Më rrallë me lidhëzat *dhe*, *edhe* ose *pa lidhëza*, me një folje tjetër në format kohore të dëftores, për të shprehur një veprim të zgjatur, të kufizuar në fillimin e tij.

Ky lloj kallëzuesi paraqitet me dy struktura : *filloj*, *zë*, *nis* + lidhëzën *e* (*dhe*, *edhe*, *pa lidhëz*) + folje në dëftore. Të dyja foljet janë në format kohore të dëftores dhe kallëzuesi shpreh një veprim të zgjatur, të kufizuar në fillimin e tij.

Fillon e harrohet pas një gjëje, mendja nis e i bredh poshtë e lart.

Djemtë e fshatit zunë e pakësoheshin gjithnjë e më shumë.

Shërbëtori zuri po i tregonte shkakun e udhëtimit.

Foljet që formojnë kallëzuesin e përbërë përputhen në vetë e në numër, po jo gjithnjë në kohë :

Gjyshi thoshte se kishte nisur e nxirrte këngë vetë.

➤ **Kallëzuesi i shprehur me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.**

Në funksion të kallëzuesit dalin edhe disa pjesëza ose fjalë onomatopeike. Kallëzues të tillë japin idenë e një veprimi. Pjesëzat *po*, *jo*, vetëm ose të përsëritura me lidhëzat *e*, *që*, *se*, p.sh. : *po që po*, *jo që jo*, *po e po* etj.

Ajo ka frikë nga gjarpërinjtë, ti jo.

A fituat ? Ne po se po.

Unë jo që jo, po edhe shefi s'kishte ftesë.

*Gjahtari qëllonte nga varka rosat e egra e ato **bëllduf** brenda në ujë.*

GJYMTYRËT E DYTA TË FJALISË

1. Ç'janë gjymtyrët e dyta të fjalisë ?
2. Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta.
3. Përcaktori.

1. Ç'janë gjymtyrët e dyta të fjalisë ?

Kryefjala dhe kallëzuesi, për të cilët folëm më lart, në fjalinë me dy gjymtyrë kryesore, përbëjnë strukturën ose qendrat e fjalisë, sepse janë elementet më të rëndësishme dhe më të domosdoshme të saj.

Gjymtyrët e tjera, që quhen *gjymtyrë të dyta*, lidhen me kryesoret nga ana strukturore e kuptimore dhe shërbejnë për t'i zgjeruar e përcaktuar më shumë ato.

Gjymtyrët e tjera që lidhen me kallëzuesin, ndahen në dy grupe:

- a. në gjymtyrë të domosdoshme të fjalisë, të cilat lidhen ngusht me kallëzuesin, ku hyjnë : *kryefjala, kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë*. Ato quhen ndryshe edhe *argumente*.
- b. në gjymtyrë fakultative të fjalisë, ku hyjnë rrethanorët.

P.sh. :

Ai ndezi një cigare tjetër, që po e thithte vrullshëm.

Sytë i mbante të ngulur në një pikë.

Iu afrua derës së dhomës së babait dhe lëvizi lehtë dorezën.

Fjala që, përveç gjymtyrëve kryesore, përmban edhe gjymtyrë të dyta, sjell edhe informacion më të pasur, duke u mishëruar në të shtjellimi dhe hollësitë e mendimit njerëzor.

Fjala, që del vetëm me dy gjymtyrët kryesore, quhet *e thjeshtë*.

Fjala, e cila përveç gjymtyrëve kryesore përmban edhe gjymtyrë të dyta, quhet *e zgjeruar*.

2. Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta.

Teoria e gjymtyrëve të dyta u bazua fillimisht në raportet kuptimore që vendosen midis dy gjymtyrëve, kur në gjuhësi mbizotëronte logjicizmi. Mbi bazën e këtyre

raporteve, dolën edhe emërtimet: *përcaktor*, *kundrinor*, *rrethanor*. Prandaj edhe klasifikimi më i përhapur dhe më i njohur i gjymtyrëve të dyta është ndarja e tyre në këto tri kategori të mëdha :

- *përcaktorë*,
- *kundrinorë*,
- *rrethanorë*,

ku kundrinori del si një gjymtyrë me një peshë më të madhe në fjali, prandaj disa studiues e kanë afruar atë me gjymtyrët kryesore. Një status të veçantë zë edhe *përcaktori*, i cili është zgjerim i grupeve emërore të fjalisë.

Përcaktorët janë gjymtyrë të dyta të fjalisë të cilat shprehin raporte midis tiparit apo cilësisë dhe bartësit të saj. Ata shprehen zakonisht përmes një mbiemri, emri a fjale tjetër emërore, si dhe me ndajfolje apo forma të pashtjelluara foljore. Përcaktorët brendapërbrenda klasifikohen mbi bazën e kriterit të lidhjes sintaksore. Sipas këtij kriteri dallojmë :

- *përcaktorë me përshtatje*,
- *përcaktorë me drejtim*,
- *përcaktorë me bashkim*.

Rrezet e fundit të diellit binin mbi plugjet.

Më mungon vetëm ajo shkolla që ke ti.

Sapo përcolli për në spital të plagosurin e dytë.

Merreni këtë tufë lulesh.

Gjithçka për rreth ishte e shkretë.

Çdo gjymtyrë ka lidhjen e saj tipike. Lidhja tipike e përcaktorit është përshtatja.

Një lloj përcaktori me përshtatje është edhe *ndajshtimi*.

Pylli aty afër gumëzhinte nga era.

Kundrinorët janë gjymtyrë të dyta të fjalisë me të cilat shprehen marrëdhënie objektore ndërmjet një veprimi a tipari dhe objektit të tij. Kundrinorët lidhen me drejtim me gjymtyrët varëse. Kjo është e vetmja lidhje e tyre.

Ai i shkroi një letër vëllait.

Rrethatorët janë gjymtyrë të dyta që hyjnë në marrëdhënie rrethatore me gjymtyrët nga të cilat varen. Si kundrinorët, edhe këta varen kryesisht nga folje dhe mbiemra ose edhe nga ndajfolje. Në raste të tjera i referohen gjithë fjalisë dhe tregojnë rrethana të ndryshme, në të cilat kryhet veprimi apo shfaqet tipari.

Rrethatorët lidhen me drejtim dhe me bashkim.

Lidhja tipike e tyre është bashkimi. Rrethatorët ndahen në lloje sipas kriterit semantik. Pra, kemi

- *rrethatorë vendi,*
- *rrethatorë kohe,*
- *rrethatorë shkaku,*
- *rrethatorë qëllimi,*
- *rrethatorë mënyre*
- *rrethatorë sasie.*

Ai ecte poshtë e lart nëpër rrugën e shtruar me kalldrëm.

E kishte lexuar shpejt.

Plasa vape.

3. Përcaktori

Përcaktori është gjymtyra e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie përcaktore me një fjalë emërore të fjalisë dhe lidhet me të me përshtatje, me drejtim dhe me bashkim.

Përcaktori ka një pozicion të veçantë ndaj gjymtyrëve të veçanta të fjalisë. Ai është zgjerim i mëtejshëm i përbërësve emërorë të fjalisë, pra, bashkë me fjalën emërore me të cilën lidhet formon një sintagmë emërore brenda fjalisë:

Kurora e zjarrtë e diellit preku majën e naltë të Nemërçkës.

a. Përcaktorët me përshtatje

Në funksionin e përcaktorit me përshtatje mund të dalin mbiemrat, disa përemra dhe me numërorët *tre, tri, të dy, të tre* etj..

- **Mbiemrat** si përcaktorë mund të jenë të nyjshëm dhe të panyjshëm dhe shprehen karakteristika të ndryshme cilësore të kokave të sintagmave emërore, të cilat mund të jenë emra ose përemra të pacaktuar me përdorim emëror : *asgjë, gjësendi, kurrjë etj.*

Në mes të dy nofullave kishte një gropë të madhe.

Gishti tregues ishte i verdhë nga nikotina.

Ai zbatonte orarin e përpiktë zyrtar.

Diçka e frikshme po ndodhte.

Nuk po bëjmë asgjë të madhe.

- **Përemrat dëftorë** *ky, kjo, ai, ajo*, kur shërbejnë si përcaktorë me përshtatje, varen nga gjymtyrë emërore në trajtë të shquar ose të pashquar dhe nga përemra.

Pjesa më e madhe e këtyre njerëzve janë si aktorë.

Hyra në atë dhomë për një qëllim tjetër.

Përcaktorët e shprehur me përemrat dëftorë i atillë, i këtillë, i tillë, që tregojnë tipare të sendeve, varen, përveç nga gjymtyrë të shprehura me emër të pashquar apo të shquar, edhe nga gjymtyrë të shprehura me përemër të pacaktuar :

Vajzat i pëlqejnë djemtë e tillë.

Ta thotë miku një fjalë të tillë është një gjë e madhe.

A mund të gjendet diçka e tillë ?

- **Përemrat pronorë**, si përcaktorë me përshtatje, dalin në dy tipa sintagmash,
 - ✓ në një sintagmë e cila ka si kokë një emër të shquar dhe përemri del si plotësor i saj, sikurse edhe një mbiemër,
 - ✓ në një sintagmë e cila ka si kokë një emër të pashquar dhe një specifikues të shprehur me përemër dëftor a të pacaktuar. Kjo sintagmë mund të

shndërrohet në sintagmë me emër të shquar. Në sintagma të tilla bëjnë pjesë përemrat edhe kur janë të emëruar.

E mbylli jetën e saj sterrë e pa dashuri. ´

Djali i tij qe larguar prej vitesh.

- **Përemrat pyetës**, si përcaktor me përshtatje, dalin në sintagma emërore që kanë si kokë një emër të pashquar ose në sintagmë parafjalore dhe shërbejnë për të pyetur për tipare të ndryshme të sendeve. Si të tillë përdoren përemrat cili dhe i sati.

Cilët miq pret, more burrë ?

E sata makinë po kalonte ?

- Ndër **përemrat e pacaktuar**, si përcaktorë me përshtatje kryesisht përdoren përemrat : *i gjithë, i tërë, patjetër*, por edhe *cilido, secili, gjithsecili*.

Unë do të bëj si bëjnë të gjitha shoqet.

E tërë jeta e tij ishte e lidhur me këtë fushë.

E marr me mend si na shikojnë vajzat e tjera.

Ai do të provonte në trupin e tij cilëndo vaksinë.

Në secilën dorë kishte nga një shenjë.

- Përcaktorët me përshtatje të shprehur me **numërorë** janë tepër të kufizuar, vetëm numërorët *tre* dhe *të dy* (me kuptim përmbledhës) përdoren si të tillë. I pari varet nga gjymtyrë të shprehura me emër të pashquar ose të shquar, të dytët nga gjymtyrë të shprehura me emër të shquar apo me përemër dëftor.

Tre njerëz dukeshin e zhdukeshin te maja e bregut.

Duhen bërë tri pengesa në shtratin e lumit.

Tre të rinjtë bisedonin me njëri- tjetrin.

Të dy kritikët kishin ulur kryet.

b. Përcaktori me drejtim

Përcaktori me drejtim qëndron pas fjalës së pacaktuar, pra, del si plotësor i kokave të sintagmave emërore dhe shprehet me emër në rasën gjindore, në

rrjedhore e kallëzore pa parafjalë dhe në rasën emërore, në kallëzore e rrjedhore me parafjalë.

U mor parasysh mendimi i të gjithëve.

Zëri i tyre duhet të dëgjohet.

Dëgjohej kënga e zogjve të malit.

Hija e malit kishte rënë mbi fshat.

Përcaktori i shprehur me emër në rasën gjinore pa parafjalë varet nga emra të shquar ose të pashquar, nga sintagma, nga përemra vetorë ose dëftorë, nga përemra të pacaktuar dhe nga numërorë me përdorim emëror.

Tufa e fazanëve u duk përsëri në anën tjetër të pyllit.

Ne jemi njerëz të punës.

c. Përcaktori me bashkim

Përcaktorët me bashkim janë plotësorë të sintagmave emërore dhe shprehen me përemra të palakueshëm, me numërorë, me forma të pashtjelluara foljore dhe me ndajfolje.

- **Përemrat pyetës ç', sa,** e më rrallë *çfarë*, shërbejnë si përcaktorë me bashkim dhe janë plotësorë të sintagmave që kanë si kokë një emër të pashquar.

Ç'punë bërë sot ?

Sa makina kaluan në rrugë ?

Ç'njerëz ishin ata ?

Sa ëndrra të bukura kishte thurur.

- Si përcaktorë me bashkim të shprehur me **përemra të pacaktuar**, dalin këta përemra : *asnjë, ndonjë, çdo, ca, disa, shumë, pak, kaq, aq.*

Përemri *asnjë* varet nga emra të pashquar dhe përdoret në fjalinë mohore:

Në mbledhje nuk foli asnjë njeri.

Në asnjë shkollë nuk ndodhin gjëra të tilla.

Druri i tij është i butë dhe mund të pritët me çdo thikë.

Atje do të gjenin ndonjë punë.

Atë ditë shumë vajza shkuan në festë.

*Për fatin e tij ishin përhapur **kaq** fjalë, sa që tani s'i besonte njeri.*

- Përcaktorët me bashkim shprehen edhe **me format e pashtjelluara të paskajores dhe të pjesores**. Paskajorja si përcaktor me bashkim është plotësor i një sintagme emërore që ka si kokë një emër me kuptimin e dëshirës a të vullnetit : *dëshira për të ardhur, vullneti për të studiuar, shpresa për t'u kthyer, mundësia për të bërë* (diçka).

Përcaktori me paskajore tregon karakteristikë dhe shpreh

- destinacion:

Shteg për të shpëtuar s'kishte.

E nënshkrova lejen për të dalë.

- cilësi, ku paskajorja ka kuptim të afërtz me mbiemrin er nuk mund të zgjerohet :

Bleva një kostum për të qenë.

S'është fjalë për t'u thënë kjo , mor bir.

- Përcaktori i shprehur me **ndajfolje** ka një përdorim të kufizuar pranë gjymtyrësh të shprehura me emër jofoljor, por vjen duke u zgjeruar përdorimi i tij pranë emrash foljorë. Rrallë mund të përcaktojë edhe një përemër vetor ose dëftor. Në pajtim me kuptimin e tyre leksikor, ndajfoljet në funksionin e përcaktorit tregojnë karakteristikë, duke shprehur vend ose cilësi :

Vendi përreth zbardhte.

Rruga djathtas ishte e ndriçuar mirë.

Vështroi pyllin përtej.

Ai atje është vëllai im.

Ne këtej kështu e kemi.

d. Ndajshtimi

Ndajshtimi është një lloj përcaktori i shprehur me një emër të pashquar në rasën emërore që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar. Përshtatja jo e plotë e dallon atë si një lloj i veçantë përcaktori:

Profesor Agroni qëndronte krah meje.

Ndajshtimi që përcakton një emër është lloji më i përhapur i ndajshtimeve. Ai shprehet me një emër të pashquar në formën e rasës emërore dhe përshtatet vetëm në numër, p.sh. : *popull mik, popullit mik, popullin mik, popujt miq, popujve miq, ushtar Agimi, ushtar Agimit, ushtar Agimin etj.*

Ndajshtimi mund të qëndrojë pas ose para gjymtyrës së përcaktuar.

- ***Ndajshtimi që qëndron pas fjalës së përcaktuar mund të shprehet me emër të përgjithshëm***

- ✓ që tregon karakteristikë duke shënuar cilësi ose lloj.

Zemra ime plagë u lëndua më tepër.

Ashtu vazhdonte jeta e atyre njerëzve robot.

Pula mëmë vërtitet rrotull duke mbledhur ushqim.

- Për Shqipërinë zonjë! – u dëgjua një zë në mes të haresë.

Lumi Drin është lumi më i gjatë në Shqipëri.

E lexove gazetën “Shekulli,?”

Poema ”Këngët e Milosaos,, u botuan më 1836.

Kështu hyra në kafe “Kursal”.

- ✓ që emërton një vend gjeografik, një vepër letrare, një gazetë, parullë, institucion :

Lumi Drin është një burim i madh energjistik.

Anija “Skënderbeu” çante detin me tehun e bashit të vet.

- ✓ pas disa gjymtyrësh të shprehura me emrat : *fjalë, thirrje, emër, nocion etj.*

Fjala “shokë” buçiti si një bombë

Kur i shqiptonte fjalën “të dua” i rrënqethej mishtë.

Vala e isove u bashkua me thirrjet “ndal”, “uleni”, “tërhigjeni”.

- Para një gjymtyre të shprehur me emër të përveçëm, ndajshtimi i shprehur me emër të përgjithshëm të pashquar tregon karakteristikë, duke shënuar përkatësinë farefisnore, profesionin, detyrën gradën apo titullin :

Iu duk e pabesueshme kur pa në prag të derës nënë Dilën.

*Ky ishte **traktorist** Agimi që punonte edhe në shi.*

Ndajshtimi mund të përcaktojë edhe një **përemër vetor të vetës së parë dhe të dytë**. Ky lloj ndajshtimi shprehet me emër të shquar, i cili përshtatet me gjymtyrën e përcaktuar në numër dhe në rasë. Ai saktëson folësin ose bashkëfolësin të shprehur nga përemri vetor:

*Për ju **të rinjtë** demokracia hapi horizonte të reja.*

*Ne **inxhinierët** kemi bredhur shumë kantiereve.*

Ndajshtimi pranë një përemri mund të shprehet edhe me një mbiemër të emërzuar, me ndonjë përemër të pacaktuar ose edhe ne një emër në rasën gjinore të përdorur në vend të një togfjalëshi emër + emër në gjinore :

*Si ne **të medhenjtë** edhe ju **të vegjlit** duhet të bëni kujdes me shëndetin.*

*Ç'ke me mua **të shkretën** që s'më lë të qetë ?*

*Mjaft tani, se s'le gjë për ne **të tjerët**.*

*Ju shpëtova si shpëtonim kurdoherë ne **të malit**.*